

FJALA E DEPUTETIT DAMIAN GJIKNURI

E ENJTE 20 TETOR 2022

Mirëdita të gjithëve!

Të nderuar qytetarë që na ndiqni,

Të nderuar deputetë,

I dashur Dashi, meqenëse e fillove me emrin tim, me thënë të drejtën, kur të dëgjoj ty, kam një kënaqësi të veçantë, sepse ti je i vetmi që këtë temë serioze mund ta zh dramatizosh në atë mënyrë sa në fillim të flasësh për kanalin e Peqinit, më pas të flasësh për unazën e stomakut dhe në fund të lexosh ata terravatët që të ngatërrojnë, por ti s'ke faj, sepse t'i kanë shkruar të tjerët. Po për këtë ke meritë, se, në fund të fundit, në këto kohë krizash njerëzit kanë nevojë edhe për humor, dhe humori gjithmonë të çon përpara. Në fakt, ti je shumë më mirë se personi tjetër që mungon sot në sallë dhe që mund të ishte kontrast i bukur, sepse të flasë Partia Demokratike për temën e energjisë, është si të flasë varrmihësi për shëndetin e kufomës së tij. Këtu e kam fjalën për Saliun, se ai ishte varrmihësi i sektorit energjik. Unë kam pasur rastin ta përjetoja atë situatë, sepse më qëlloi të isha ministër në atë kohë kur ju dorëzuat qeverinë dhe e pashë vetë sesa thellë e kishit futur kufomën energjetike në varr dhe sesa mund u desh për ta ngjallur atë. Nuk është ngjallur aq sa duhet, sa të vrapojë, por të paktën e ngjallëm, sepse disa fakte shqiptarët s'duhet t'i harrojnë. Në fund të fundit, kontrasti ka rëndësi për politikën.

E para, ju zotëri nuk duhet të flisni për energjinë, sepse gjysma e energjisë vidhej dhe humbej në kohën tuaj. Pra, gjysma e energjisë që i shkonte rrjetit energjetik shqiptar, nuk materializohej fare në para dhe për këtë fajin patjetër e kishte varrmihësi. Ju e shitët sektorin energjetik. Ju e falimentuat OSHE-në, ÇEZ-in e asaj kohe. Kur flisni për çmime, dua t'ju them disa fakte, se mbase koha ka bërë që njerëzit t'i harrojnë, por duhet t'i kujtojnë.

Ju që mburreni për fashat e energjisë, jeni ata që futët fashën e energjisë. Ju jeni ata që e rritët çmimin e energjisë nga 4,4 lekë në 7 lekë. Pastaj, kur e privatizuat fashën e ulët, e vutë 7,7 lekë dhe fashën e lartë 13,5 lekë. Dhe e dini sa ju dilte çmimi mesatar? Ju dilte 9,7 lekë. Unë kam luftuar shumë që ta hiqja fashën. Unë besoj se fashat nuk janë metodat e duhura. Por ndryshe nga fasha e asaj kohe, që kishte për qëllim se si e si të ngarkonte më shumë konsumatorin (prandaj dilte çmimi mesatar aq i lartë), kjo fashë është e përkohshme. Pra, e thënë qartë: fashë e përkohshme, për një periudhë shumë të kufizuar, që lidhet me një krizë, e cila nuk ka për qëllim të ngarkojë konsumatorin. Sepse fasha e parë prej 7,7 lekësh dhe fasha e dytë 13,5 lekësh, që i vendosët ju, ishin për 300 kilovatë, kjo është për 800 kilovatë, nga e cila preken shumë pak familje.

Natyrshëm, asnjë nuk e do këtë gjë, sepse diferencat mund të krijojnë probleme në administrim, por thashë: është e përkohshme dhe reflekton një krizë që është ndërkombëtare. Ju e shikoni, sot në Bashkimin Europian po diskutojnë si të kontrollojnë çmimin e gazit. Ka shtete që s'e duan këtë gjë, sepse po të vihet çmim gazi i kontrolluar, mund të mos ketë gaz. Pra, ka debate shumë të forta për këtë gjë. Në Shqipëri kjo krizë nuk po ndihet te buxhetet familjare, sepse të gjithë riskun, këtu u tha pak më parë, që nuk duhet të jetë kështu, po kështu është realiteti, e ka marrë qeveria, e mban buxheti i shtetit. Buxheti i

shtetit është ai që kompenson të gjitha efektet e çmimi të energjisë. E kemi bërë vetëm e vetëm që t'i vijmë në ndihmë konsumatorit, të mbrojmë biznesin prodhues, sepse edhe biznesi prodhues ka çmim të rregulluar të energjisë sot, që normalisht duhej të ishte i ekspozuar në treg. Kështu që, këtë kosto e ka mbajtur buxheti i shtetit dhe qeveria. Pse? Që të mbajë veprimtarinë prodhuese hapur dhe të mos kemi një krizë më të madhe ekonomike. Po këto janë masa sociale, janë masa që na kushtojnë, por gjithmonë, jo për interes të asaj që thoni ju, që të vidhet apo në interes të të mëdhenjve, përkundrazi, këto janë masa që shkojnë në dobi të konsumatorëve.

Po le të vazhdojmë, se ju keni ngritur disa mite për energjinë, për të cilat dua të flas, që t'i dëgjojnë një herë e mirë shqiptarët. Thoni që na kanë shpëtuar asetet private që ka ndërtuar Sali Berisha. Po ju jap disa shifra, që t'i dini. Deri në vitin 2013 janë ndërtuar nga investitorët privatë 373 mega prodhim energjie, në vitin 2021 janë 727 mega. Pra, është prodhuar më shumë energji nga 2013 deri në vitin 2021. Raporti është 2 me 1, ashtu siç e kam thënë një herë, që me këtë rezultat do të dalin edhe zgjedhjet minimalisht 2 me 1. Pra, qeveria e Partisë Socialiste gjatë këtyre 8 vjetëve i ka dyfishuar kapacitetet prodhuese që latë ju.

Pra, ky është miti i parë, që përmendni, i cili fatkeqësisht nuk ka gjetur përgjigje, por kjo është e vërteta me shifra.

E dyta, kur flisni përsëri për HEC-et private, dua t'ju them një fakt, që nuk duhet të harroni, se më keni sulmuar shumë atëherë, kur fillova rinegocimin e kontratave, ne ndryshuam edhe legjislacionin për të rregulluar çmimin e energjisë dhe u treguam largpamës. Pse? Vendosëm një bazë mbrojtëse, një dysHEME mbrojtëse, por vendosëm edhe një tavan, që kur të vinin krizat, fatura të mos i shkonte publikut. Dhe a e dini që për gati dy terra energji që prodhohen sot, në qoftë se do të ishte ende ajo formula e famshme e Sali Berishës (që nuk është këtu) sa do të paguante sektori energjetik shqiptar? Minimalisht 500 milionë euro më shumë. Pra, sektori do të ishte drejt falimentimit. Dhe kjo është bërë përsëri, jo për të ndihmuar privatën, oligarkun, apo biznesin, por për t'i dhënë biznesit qëndrueshmëri në rritjen e tij dhe njëkohësisht për të mbrojtur tarifat e energjisë. Se Shqipëria një sfidë ka, që, në fakt, e ka çdo qeveri, si të mbahet në kontroll tarifa e energjisë. Me projektet tuaja, me atë që bëtë ju, me privatizimin e OSHE-së dhe me falimentin e saj, çmimi i energjisë do të shkonte mbi 10 lekë në atë kohë, me vlerat e asaj kohe, por falimentoi, e futët tamam në varr sektorin, ne e morëm dhe e ringjallëm. Dhe falë punës së pamohueshme të mijëra burrave dhe grave, si në terren, ashtu edhe në zyrat e atij shteti, që ju gjithmonë mundoheni ta anatemoni, a thua se do të bëhet puna pa shtet, sektori sot e ka tejkaluar përgjysmimin e humbjeve nga 45% në 22%. Këto janë vlera monetare, që u kanë ardhur në ndihmë qytetarëve shqiptarë.

Po të them një gjë tjetër, të cilën ju s' doni ta përmendni. E di çfarë bëtë ju, more zotëri? Se ju jeni të vetmit që mund ta keni bërë këtë gjë, por çudi, më vjen keq nuk përmendet kjo gjë. Ju shitët 87 mega Bisticën, Shkopetin, Ulzën, hidrocentrale të investuara, kredi të marra nga korporata elektro-energetike. Dhe kam përshtypjen se këto kredi vazhdojnë të paguhen ende sot, se nuk janë maturuar të gjitha, se edhe kur isha unë ministër, vazhdonin të paguheshin, por ministrja duhet të dijë më mirë këtë gjë.

Pra, ju i shitët. A e di se me çfarë vlere i shitët? A e di sa i shitët? Me 1,3 milionë euro mega. Ndërkohë, hidrocentralin e Lana Bregasit e shitët me 3 milionë euro mega, tamam një shitje nën vlerë. Dhe çfarë hidrocentralesh ishin! Plotësisht të rinovuara, sidomos ata të Bisticës, që janë si TEC, gjithmonë kanë ujë, gjithmonë prodhojnë energji sipas parashikimit, sikur të jenë një TEC. Ky është në krim që i keni bërë sektorit energjetik.

A e dini që po t'i kishim sot ato HEC-e, nuk do të ishte fare e nevojshme kjo fasha e çmimit? Po të ishin ato 80 mega, që ju keni shitur në mënyrë kriminale, sot nuk do të kishim nevojë fare për atë fashë. Prandaj mos spekuloni me fashën! Mua më vjen mirë që qeveria e rishikoi.

Pse thoni ERE-ja dhe qeveria? Vërtet ERE-ja është enti rregullator, por për asetet dhe për çdo politikë të energjisë përgjegjës është Këshilli i Ministrave. Në bazë të aseteve që ka dhe në bazë të kostove të prodhimit, është qeveria ajo që i propozon ERE-s tarifat e caktuara.

Në fund të fundit, unë shpresoj dhe mendoj se me administrimin e mirë të sektorit, por njëkohësisht, mbase, shpresojmë, edhe me ndonjë rregullim të çmimeve ndërkombëtare, ne të kemi mundësi të mos e implementojmë fare këtë fashë. Kjo është shpresa ime.

Megjithatë një gjë duhet theksuar, kjo fashë vjen për një periudhë të përkohshme dhe jo me qëllimin që patët ju, kur vendosët fashën 13,5 lekë, që si e si t'i krijonit të ardhura ÇEZ-it, që e kishit klient kur e privatizuat. Po të vazhdonte ajo skemë privatizimi, ta dinë gjithë shqiptarët, çmimi i energjisë i asaj kohe do të ishte 1 lek më i lartë se sot, por nëse sektori do të ishte në duart e privatit, nuk do të kishte burrë nëne ta mbronte konsumatorin shqiptar nga ajo masakër që bëtë ju. Kjo është e vërteta. Këto janë të vërteta historike.

Për sektorin energjetik, unë ia kam thënë edhe atij kur e kam pasur përballë, se edhe më kanë akuzuar: ju nuk keni të drejtë të flisni. Ju duhet të jeni si ai njeriu që ka bërë një krim dhe pendohet, ul kokën, nuk do të flasë për atë gjë, sepse dështoi, dështoi në mënyrë glamoroze.

Të mos hapim historitë e ÇEZ-DIA-s pastaj, sepse sa më shumë të fusësh duar tek ajo që keni bërë ju me energjinë, aq më e tmerrshme është. 1,3 miliardë dollarë i latë borxhe. Për çfarë flet ti, Dashi, për institucionet? Po ti shiko arkëtimet! Sot arkëtimet janë 80 miliardë, ndërkohë në kohën tuaj ishin 38,1 miliardë lekë. Tani, si rritet borxhi, kur rritet arkëtimi? Arkëtimi rritet duke ulur borxhin. Pra, faturat likuidohen në kohë. Patjetër, ka borxhe, ka njerëz që nuk paguajnë, ka institucione që paguajnë me vonesë, por nuk mund të krahasohet me kohën tuaj.

Se mos harrojmë dhe atë gjënë tjetër. E dini çfarë bëtë ju? Ju bëtë shpikjen më interesante, duke u dhënë kompanive të mbledhjes së borxhit target që të mbledhnin borxhet e qeverisë. Ministrinë në vend që të paguanin ÇEZ-in direkt, paguanin nëpërmjet DIA-s apo shoqeve të DIA-s dhe ato përfitonin nga buxheti i shtetit.

Megjithatë, Dashi, ti ke një meritë si peqinas i mirë që je, që ke humor, dhe humori do të nxjerrë gjithmonë përpara, ti e përzjeve aq bukur situatën, se po të ishte ai tjetri, varrmihësi, duhet të ulte kokën dhe mos fliste për viktimën e tij. Sukses!